

AKT- THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Synergy Company” shpk

Ne Durres, sot me date 06/10/2022, ortaket themelues te shoqerise
“Synergy Company” shpk

Z. Eno Hoxholli, i biri i Xhevdet, i datelindjes 06/08/1993 , lindur ne Porocan, Gramsh e banues ne Durres, shtetas Shqiptare, madhor, dhe me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar me karte identiteti me numer J30806065K.

Z. Xhevdet Hoxholli i biri i Sherif , i datelindjes 06/01/1963 , lindur ne Kabash, Gramsh e banues ne Durres, shtetas shqiptar, madhor, dhe me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar me karte identiteti me numer G30106037E.

Te cilet me cilesine e “Ortakeve themelues” kerkuan redaktimin e ketij akti themelimi, nepermjet te cilit deklaroi se me vullnet te lire te plote e te sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregetaret dhe shoqerite tregetare”, ligjin nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregetare, me pergjegjesi te kufizuar, “Synergy Company” shpk .

KREU I

Neni 1

Krijimi

“Synergy Company” shpk.

Eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria “Synergy Company” shpk , eshte nje shoqeri tregetare, e themeluar nga shtetasit shqiptare:

Z. Xhevdet Hoxholli, **Z. Eno Hoxholli**, te cilet pergjigjen per detyrimet e shoqerise tregetare dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara. Kontributi i ortakeve perben kapitalin e regjistruar te shoqerise.



Neni 3
Selia

Shoqeria e ka seline ne: Lagjia Nr.15, Rruga "Shen Maria", Objekt me Nr Pasurie 9/38, ZK8511, Durres. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filial, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Ortakeve themelues.

Neni 4
Objekti i veprimtarise

Tregtim me shumice dhe pakice, import-eksport I materialeve, makinerive, pajisjeve dhe impianteve te ndryshme elektrike, impianteve/paneleve fotovoltaike,elektroshtepiake, elektronike, sistemeve/impianteve termike,te ftohjes e ngrohjes (kondicionimit), sisteme per miremenaxhimin e energjise, sisteme ndricimi, te telekomunikacionit si dhe impianteve te tjera te ngjashme te destinuara per objekte civile dhe industriale, per sektore te ndryshme. Sherbim, projektim, supervizim, kolaudim, furnizim, dhe vendosje te produkteve elektrike, mekanike te tensionit te ulet, te mesem dhe te larte. Punime elektrike te objekteve industriale dhe civile. Projektim dhe zbatim per energjine e rinovueshme solar, ere dhe Hidro. Furnizim-vendosje materiale hidraulike, sanitare, vegla pune, materiale ndertimi, kancellerie etj. Ndertimi i impianteve Elektro-Energjitike. Auditim Energjie. Menaxhim Energjie, Auditim i eficences se energjise ne Ndertesa dhe Procese. Sherbime ESCO. Ofrimi i konsulences dhe asistences teknike per projektimin, mirembajtjen, riparimin, prodhimin e pajisjeve elektrike, fotovoltaike, dhe te cdo materiali tjetër ndihmes te sistemit dhe rjetit elektrik. Tregtim dhe shitje e energjise elektrike. Aktivitete inxhinierike dhe konsulenca teknike te lidhura me to.

Neni 5
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

KREU II
Kapitali
Neni 6
Kapitali themeltar



Kapitali themeltar i shoqërisë është 200000 leke (Dyqind mijë leke), i cili ndahet në 2 kuota, në raport me kontributin e dhënë nga ortakët në shoqëri ku ortakët zoterojnë kuota të ndara si më poshtë :

Ortaku, **Z. Xhevdet Hoxholli**: zoterues i një kuote me vlerë të përgjithshme 80000 leke, që përbejnë 40 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaku, **Z. Eno Hoxholli**: zoterues i një kuote me vlerë të përgjithshme 120000 leke, që përbejnë 60 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuota e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendren Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendren Kombëtare të Biznesit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Ortakët e shoqërisë janë organi vendimmarres i shoqërisë. Ortakët e shoqërisë janë organi vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Ortakët vendosin për çështje si :

- a) Përcaktimi i politikave tregëtare të shoqërisë
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- c) Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar



- d) Percaktimin e shperblimeve
- e) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- g) Miratimin e rregullave procedural te mbledhjeve te asamblese;

Te gjitha vendimet e marra nga ortaket e shoqerise regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne veçanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per :

- a) Miratimine pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim , perveç rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

Neni 9

Administrim

Administrator i shoqerise “**Synergy Company**” shpk caktohet Brenda ortakerise. Ortaku **Z. Eno Hoxholli** emerohet Administrator i shoqerise per nje afat 5 vjeçar me te drejte ripertesitje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese e ortakeve te shoqerise.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka te drejte e detyrohet te :

- a) Kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) Perfaqesoje shoqerine tregtare;



- c) Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d) Pergatisi dhe nenshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shpendarjen e fitimeve i paraqesin keto dokumenta perpara asamblese se pergjithshme per miratim
- e) Krijoi nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- f) Kryej regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise sic parashikohet ne ligjin per QKR.
- g) Raportoi perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.

Administratori eshte i detyruar te therrase ne mbledhjen e asamblese ne rastet kur :

Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kerkueshme Brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria , brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj,propozon te bleje nga nje ortak pasuri,qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise,qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Administratoret, si se bashku edhe vecas njeri tjetrit, kane te drejte te kryen te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtzakonshem. Administratoret e perfaqesojne shqiperin perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe /ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te gjitha shkalleve. Administratoret kane te gjitha kompetencat per te vepruar ne mardhenie me te tretet ne emer te shoqeris, net e gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ja jep shprehimisht ortakeve te shoqeris.


Administratoret angazhon shoqerin ne mardheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj. Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti I administratorit e kalonte objektin e shoqeris ose per te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk esht prov e mjaftueshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti Financiar i shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor. Perjashtimisht , viti i par Financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerisë ne QKB dhe mbyllet ne 31 dhjetor.

Neni 12



Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj.
- b) me vendim te ortakve themelues
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit
- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk esht njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 , date 3.5.2007 “Per Qendren Kombtare te Biznesit”
- e) me vendim te gjykates

Ne kete rast Asambleja e Pergjithshme merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo document te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ shoqeri ne likuidim e siper”

Neni 13

Baza ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjiit “Per tregtaret dhe shoqerit tregtare”, Kodit Civil dhe cfar do ligji tjeter specific ne Republiken e Shqiperis.

Neni 14

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlere te njejta juridike.

Akti i mesiperm pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare “**Synergy Company**” shpk , nenshkruset ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin , mbiemrin dhe firmen e tij origjinale .

ORTAKET THEMELUES

Eno Hoxholli

Xhevdet Hoxholli